



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 8

Prishtinë, më 18.05.2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq, Blerta Deliu - Kodra, Vjosa Osmani, Alma Lama, Blerim Shala, Suzana Novobërdali dhe Albert Kinolli.

Munguan: Fatmir Limaj dhe Nekibe Kelmendi.

Me ftesë: Mimoza Kusari – Ministre e Tregtisë dhe Industrisë dhe Bajrush Xhemajli – kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha – koordinatore, Safet Beqiri – zyrtar për Integrime Evropiane dhe Pajtim Gashi - praktikant.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumni Rama – OSBE, Artan Canhasi – EULEX, Mimoza Gojani – Ambasada Britanike, Rexhep Bllaca dhe Taulant Kryeziu – Ministria e Integrimit Evropian dhe Venera Mjekiqi – Kuvend.

Mbledhjen e kryesoi Lutfi Haziri – kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

R E N D I I D I T Ë S:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 04. 05. 2011 dhe të 11. 05. 2011;**
- 3. Diskutimi lidhur me përfaqësimin e Kosovës në CEFTA: E ftuar Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë znj. Mimoza Kusari – Lila;**
- 4. Diskutimi lidhur me procesin e riatdhesimit dhe riintegritimit nëpër komuna: I ftuar Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z. Bajrush Xhemajli.**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me këto ndryshime, duke filluar me pikën e katërt të rendit të ditës si në vijim.

2. Diskutimi lidhur me procesin e riatdhesimit dhe riintegritit nëpër komuna: I ftuar Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z. Bajrush Xhemajli..

Kryetari – falënderoi kryetarin e Asociacionit të Komunave të Kosovës Bajrush Xhemajli dhe tha se çështja e riatdhesimit dhe e riintegritit në vendin tonë është shumë me rëndësi, prandaj duhet pasur kujdes në përcjelljen e këtij procesi si hap i rëndësishëm për të ecur përpara. Në takimet që janë zhvilluar me Ministrinë e Integritit Evropian janë bërë evidente problemet e riintegritit në nivel komunal, prandaj ju jeni të ftuar të raportoni si asociacion.

Bajrush Xhemajli – Foli për obligimet e komunave të Kosovës karshi qytetarëve në procesin e rëndësishëm të riatdhesimit dhe të riintegritit. Tha se komunat janë të angazhuara që procesi i riatdhesimit të përfundoj me riintegrim në përputhje me standardet dhe me aktet ligjore.

Komunat kanë rol të rëndësishëm në formimin e politikave dhe të praktikave që e mundësojnë një qasje të barabartë të qytetarëve dhe të të gjitha komuniteteve t'i kryejnë shërbimet publike, të krijojnë kushte për kthim dhe për riintegrim të të gjithë refugjatëve, të personave të zhvendosur dhe të personave të riatdhesuar. Komunat janë aktorë kyç përgjegjës për riatdhesim dhe për riintegrim për nivelin komunal në bashkërendim dhe në bashkëpunim të ngushtë me nivelin qendror. Komunat i kanë emëruar zyrtarët për riintegrimin e personave të riatdhesuar (240 prej tyre) nga të gjitha komunat e Kosovës, duke i përjashtuar tri komunat në Veri. Këta zyrtarë tashmë e kanë kaluar fazën e tretë të trajnimit në procedurën e riintegritit. Po ashtu tha se komunat angazhohen që personat e riatdhesuar ta fillojnë procesin e riintegritit në shoqërinë kosovare. Ky proces ka filluar me futjen e tyre në regjistrin civil, në qasjen e tyre në shërbime shëndetësore, në arsim, në udhëzimin për qendrat rajonale për punësim, në kycjen në programet e mirëqenës sociale dhe në programet për banim social dhe pronë. Zyrtat për komunitete dhe kthim e mbikëqyrin gjendjen e personave të kthyer dhe raportojnë për nevojat dhe për shqetësimet e tyre te organet përkatëse komunale. Shpeshherë zyrtarët për komunitete dhe kthim në komuna e përfaqësojnë pikën e parë të kontaktit për personat e riatdhesuar në

nivel komunal, që janë përgjegjës të sigurojnë informata për të drejtat e personave të kthyer dhe në të njëjtën kohë të raportojnë për nevojat e personave të riatdhesuar te zyrat e tjera kompetente të administratës në nivel komunal.

Zyrat komunale për komunitete dhe kthim mbajnë një bazë të të dhënave, duke i përfshirë të dhënat personale dhe për nevojat e veçanta për personat e riatdhesuar. Në këtë mënyrë bashkërendohen këto zyra me Ministrinë e Administrimit dhe të Pushtetit Lokal për të siguruar që informatat të merren para arritjes së personave të riatdhesuar, që të adresohen në mënyrë të duhur.

Gjithashtu pohoj se komunat kanë mundësi që procesin e riintegritimit ta përfundojnë deri në pikën finale, pra riintegrimin e tyre të tërësishëm në shoqëri, edhe pse ka mungesa buxhetore dhe materiale. Komunat e Kosovës janë të përkushtuara për bashkëpunim me institucionet e nivelit qendror, veçanërisht me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe me Ministrinë e Administrimit dhe të Pushtetit Lokal. Komunat e Republikës së Kosovës kanë qasje në fondet prej 3.5 milionë euro, të miratuar dhe të ndarë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për qëllime të riintegritimit të personave të riatdhesuar. Po ashtu ka vendim politik që njeri nga nënkryetarët e komunës të ngarkohet formalisht me çështjet e riintegritimit dhe në përgjithësi me integritime evropiane. Qeveria do ta miratojë një rregullore të re, në bazë të cilës do të funksionalizohen zyrat në nivel komunal. Në majin e kaluar kryetarët e komunave kanë zhvilluar një takim të përbashkët me Ministrin e Punëve të Brendshme, me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe me Ministrinë e Shëndetësisë, me qëllim të adresimit të problemeve dhe të koordinimit të problemeve që i hasin komunat në këtë proces.

Kryetari - Tha se gjatë këtij muaji në Kosovë do të jetë një komision vlerësues për punë të brendshme të BE-së, që do të merret në veçanti me çështjet që kanë të bëjnë me riatdhesimin e qytetarëve të Kosovës. Përveç angazhimeve shtesë të zyrtarëve, sa keni mundësi t'i përmbushni kapacitetet për detyrat në afate të gjata kohore?

Xhavit Haliti - A ka ndonjë komunë me probleme specifike në lidhje me riatdhesimin, që mund të paraqiten në mënyrë specifike dhe a mund të këtë probleme të tjera përveç buxhetit?

Alma Lama - Pati vërejtje për mos dërgimin e raportit me shkrim tri ditë para takimit dhe pyeti: A dihet konkretisht sa është numri i persona të riatdhesuar në Kosovë? Po ashtu tha se po dëmtohet buxheti i Kosovës, sepse po ndërtohen shtëpi, që po mbeten bosh dhe në anën tjetër kemi persona që kanë nevojë për këto shtëpi. Çka do të ndërmerret për këtë çështje që buxheti i Kosovës të mos dëmtohet dhe mos bëhet fjalë në këtë rast për moskoordinim me Qeverinë?

Albert Kinolli - Cili është niveli i bashkëpunimit të Asociacionit të Komunave të Kosovës me komunat në përgjithësi, ndërmjet jush dhe zyrave komunale për komunitete? Nëse keni shifra na tregoni sa persona janë kthyer dhe si Asociacion sa jeni të kënaqur me kthimin e komunitetit rom?

Sasha Milosavljeviq – Pyeti kryetarin e Asociacionit të Komunave të Kosovës: A duhet çdo komunë ta ketë zyrtarin për integritet evropian dhe a mjafton kjo për çështje të riintegritetit dhe të riintegritimit?

Bajrush Xhemajli - Kemi kolegjiun ku takohen të gjitha komunat në sektorët për integritet evropian, me zyrtarët përgjegjës të cilët takohen dhe diskutojnë për çështje që janë aktuale. Sa u përket kapaciteteve është problematike çështja e rritjes së numrit të punëtorëve, sepse numri i tyre është i limituar. Është vështirë të realizohet krijimi i një njësie për integritet evropian dhe është sugjeruar që zyrtarët për integritet evropian të merren brendapërbrenda stafit të komunës, dhe jo të merret dikush që është i kualifikuar nga jashtë, në mënyrë që ta japë kontributin e tij.

Problemet e riintegritetit dhe të riintegritimit nuk janë vetëm probleme të komunave, por të Kosovës në përgjithësi. Si shembull mund ta marrim Komunën e Ferizajt, ku janë ndërtuar afro 200 shtëpi (saktësisht 196). Ajo e ka bërë një kontroll, kush është në ato shtëpi dhe ka dalë se janë rreth 70 persona prej afro 200 familjeve. Për ndërtimin e këtyre shtëpive varet sa para kanë komunat, pastaj çështja është si të bëhet riintegriteti. Si shembull po ashtu është ndërtimi i shkollës, por që nuk shfrytëzohet për mësim. Riintegriteti mund të bëhet nëse njerëzit kthehen me familje dhe jo si individë për të jetuar në Kosovë. Sa i përket sigurisë nuk ka pasur probleme me përjashtim në Veri të Kosovës, ku tri komuna nuk janë të përfshira në Asociacionin e Komunave të Kosovës. Sa u përket qëndrimeve për kthim Ministria për Kthim dhe Komunitete e di numrin e të kthyerve, kurse komunat kryesisht merren me çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet e qytetarëve.

Politikat e riintegritetit e tejkalojnë mundësinë e nivelit komunal. Ato hartohen nga Qeveria, kurse komunat merren kryesisht me riintegritetin e tyre në nivel komunal. Kur bëhet fjalë për ndërtimin e shtëpive shtrohet çështja kujt t'i jepet përparësi dhe dihet se janë disa kriteret për ata që duan të kthehen. Ka njerëz që iu ka ndërtuar shtëpia, por nuk janë kthyer. Komunat duhet t'i identifikojnë njerëzit që vërtet duan të kthehen dhe të jetojnë me familje në Kosovë e jo vetëm ta marrin një shtëpi. Për një riintegritet të qëndrueshëm duhet të ketë kushte më të mira se sa ekzistojnë sot.

Asociacioni i Komunave të Kosovës është i kënaqur me bashkëpunimin me të gjitha komunat, duke i përjashtuar tri komunat në Veri. Ne jemi duke bërë një turne nëpër komuna për t'i parë

hallet e tyre së afërmi. Sa i përket komunitetit RAE e dimë se në cilat komuna gjendja e tyre është më e rëndë. Kemi folur gjithashtu për riatdhesim dhe për riintegrim të serbeve, por në një gjendje shumë më të rëndë është komuniteti RAE. Ne si asociacion nuk mund të realizojmë diçka për këtë çështje, sepse nuk kemi mekanizëm, por mund të ngremë shumë çështje dhe t'i adresojmë në Qeveri. Komuniteti RAE e ka paraqitur kërkesën për t'u riatdhesuar dhe është në procedurë të kthimit. Çdo komunë së paku duhet ta ketë një zyrtarë për integritet evropian. Për t'u krijuar një njësi nevojiten mjete dhe leje, por paraqitet pengesë pamundësia për t'u zgjeruar administrata.

Kryetari - Tha se pritet që Kosova ta marrë vlerësimin nga komisionari i BE-së për çështje të brendshme, sepse përveç pesë shteteve, që nuk e kanë njohur Kosovën, kemi shtete, si Franca, që kanë dalë kundër procesit të liberalizimit të vizave. Një përkrahje më e madhe duhet për komunat që t'i ngritin kapacitetet dhe mundësitë e tyre. Tri shtete, si Franca, Belgjika dhe Suedia, kryesisht kanë pasur probleme me azilkërkuuesit. Qëllimi ynë është të shihet sa janë ndërtuar mekanizmat për riatdhesim dhe për riintegrim, në mënyrë që pastaj si Komision të ndikojmë te Qeveria të realizojë mundësi buxhetore për përmbushjen e detyrave. Ministria për Integritet Evropian çështjen e riintegritimit të personave të riatdhesuar e ka caktuar si problem të komunave. Nga ky Asociacion ajo kërkoi koordinim më të mirë me nënkryetarët e komunave dhe me zyrtarët për integritet evropian në komuna, në mënyrë që këtë vit Kosova të ketë notë pozitive për procesin e liberalizimit të vizave.

Albert Kinolli - Pasi thatë se në Komunën e Ferizajt janë ndërtuar 196 shtëpi, cilave komunitete dhe cilave kategori u përkasin këto shtëpi?

Bajgush Xhemajli - Këto shtëpi i përkasin kryesisht komunitetit serb dhe tri ose katër familjeve të komunitetit RAE.

Blerta Deliu – Kodra – Meqë u cek nga kryetari i Asociacionit të Komunave për ndërtimin e shtëpive në Komunën e Ferizajt, është me interes të dihet si është gjendja e komuniteteve të tjera dhe sa u ofrohet ndihmë për strehë kategorive përkatëse. Ju po ashtu e përmendet mungesën e buxhetit. A keni kërkuar nga Qeveria e Kosovës mjete shtesë për realizimin e projekteve për riatdhesimin dhe për riintegrimin e këtyre personave?

Suzana Noveberdaliu – A duhet ta bëjë shteti i Kosovës riintegrimin e të gjithë personave të riatdhesuar në vendin tonë dhe a është riintegrimi i barabartë për gjithë të kthyerit?

Alma Lama - Sa janë duke bërë komunat për t'i identifikuar azilkërkuesit, sepse një numër i tyre po përpiqen të përfitojnë materialisht (shtëpi)? A ka afate të caktuara për personat që i shfrytëzojnë këto ndihma? Të ndërpritet diskriminimi që bëhet me ndërtimin e këtyre shtëpive, sepse kemi edhe persona të tjerë që kanë nevojë për strehim.

Bajgush Xhemajli - U përgjigj se Asociacioni i Komunave nuk ka statistika, por në të gjitha komunat ka përparim në këtë drejtim. Shembulli më i mirë për këtë është Komuna e Gjilanit, që qëndron më mirë sa u përket këtyre çështjeve. Ata persona që janë të interesuar për t'u kthyer e kanë mekanizmin përkatës për kthim. Një takim është organizuar në Durrës midis Komunës së Shtërpcës dhe asaj të Ferizajt, që janë fqinjë. Për kthimin e të zhvendosurve nuk ka pasur një shifër për numrin e të kthyerve, por është kërkuar të evidencohen. Për këtë çështje buxheti është shumë i rëndësishëm. Siguria e lëvizjes është e mirë dhe ka hapësirë që të realizohet kthimi. Afati për ndërtimin e shtëpive është dhjet vjet. Sa u përket mashtrimeve të mundshme komunat janë përgjegjëse, sepse ato e bëjnë verifikimin e këtyre personave. Mashtrime ka pasur nga komuniteti serb dhe nga komuniteti RAE, sepse është vërtetuar se ka pasur nga ata që kanë përfituar, edhe pse nuk janë banorë të Kosovës.

Kryetari - E falënderoj Bajrush Xhemajlin që ju ka përgjigjur ftesës. E falënderoj për pjesëmarrje edhe ministren për Tregti dhe Industri, Mimoza Kusari – Lila. Ne e kuptojmë se çështja e riatdhesimit dhe e riintegritimit do të jetë nën llupen e monitorimit këtë vit. Do të jemi në gjendje t'i shtojmë mjetet buxhetore dhe kapacitetet, në mënyrë që ky proces të drejtohet mirë dhe të marrë notën pozitive, sepse qytetarët e Kosovës kanë nevojë për një qarkullim të lirë. Kosova duhet ta nënshkruajë marrëveshjen me çdo shtet për çështje të riatdhesimit.

3. Diskutimi lidhur me përfaqësimin e Kosovës në CEFTA: E ftuar Ministria e Tregtisë dhe Industrisë znj. Mimoza Kusari – Lila.

Kryetari – Pohoj se në bazë të Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrim evropian është ftuar Ministria e Tregtisë dhe të Industrisë të raportojë para Komisionit dhe të sqarojë në mënyrë specifike lidhur me CEFTA-n, për rolin e Kosovës dhe për vështirësitë që ekzistojnë rreth kësaj çështjeje. Janë vërejtur vështirësi serioze në këtë drejtim. Ne si Komision do të mbështesim që të tejkalohen ato dhe do të ndikojmë nëpërmjet mekanizmave të Parlamentit Evropian për këtë çështje. Për këtë do ta shfrytëzojmë vizitën që një delegacion i BE-së do t'ia bëjë Kosovës këto dy ditë.

Mimoza Kusari – Lila – Tha se ftesa e Komisionit ka ardhur në momentin e duhur, kur është ri-aktualizuar çështja e CEFTA-s dhe në vitin kur Kosova e kryeson këtë Marrëveshje. Prezantimin që do ta bëjmë para jush do ta ndajmë në dy pjesë: *e para* është një histori e shkurtër e kësaj Marrëveshjeje dhe përfshirja e Kosovës në këtë Marrëveshje. *E dyta* është udhëheqja e Kosovës në Sekretariatit e CEFTA-s, gjegjësisht marrja e udhëheqjes nga Kosova, si dhe problemet me të cilat po ballafaqohemi. Ajo u shpreh e hapur për pyetjet dhe për komentet eventuale rreth vizitës së fundit të realizuar në Bruksel dhe për takimet që janë zhvilluar edhe me sekretariatit e CEFTA-s, me komisionarin për zgjerim z. Fyle, si dhe për vizitat e ardhshme në këtë fundjavë të presidentit të Komisionit Evropian, z. Barroso dhe të komisionarit Fyle në Kosovë, me qëllim që institucionet e Kosovës në mënyrë të qartë ta kenë një linjë të komunikimit për problemet me të cilat ballafaqohet Kosova.

Marrëveshja është nënshkruar në periudhën 2004 - 2006, ndërsa Kosova në atë kohë i ka pasur të nënshkruara katër marrëveshje bilaterale me vendet e Ballkanit, që pastaj janë bërë anëtare në CEFTA-s. Më 2006 është nënshkruar përfundimisht Marrëveshja dhe Kosova është bërë anëtare e kësaj Marrëveshjeje me tetë shtete të tjera. Në këtë kohë Kosova ende nuk e kishte të shpallur pavarësinë e saj, dhe nënshkruese në emër të Kosovës ishte UNMIK, që mbeti institucioni i vetëm që nënshkruante dhe paraqiste kërkesa në emër të institucioneve në formë të shkruar në CEFTA. Deri me tani jemi ballafaquar me një situatë jo të favorshme, sidomos pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 2008, pas secilës është ndërruar formati i vulave të doganave të Kosovës, vula këto të njohura nga ana e UNMIK, por të papranuara nga ana e Serbisë. Si rrjedhojë Serbia e ka bllokuar lëvizjen e lirë të mallrave dhe bashkë me Bosnjën dhe Hercegovinën dhe me Moldavinë. Problemet serioze me Serbinë dhe me Bosnjën dhe Hercegovinën, që i janë paraqitur Kosovës kanë të bëjnë kryesisht me transitin e mallrave që kalojnë nëpër këto vende. Si shtet synojmë në vazhdimësi të tregojmë konstruktivitet, por problem tjetër është mosrespektimi nga Serbia i Marrëveshjes që e ka nënshkruar. Ne gjendemi në një situatë që të vendosim ta përdorim mekanizmin e arbitrit për zgjidhjen e kontestit. Për këtë është dashur të autorizohet UNMIK-u, që ta përfaqësonte Kosovën në zgjidhjen e kontestit në Sekretariatit e CEFTA, por e dimë se prej mandatit të kaluar, kur është shpallur pavarësia e Kosovës, Qeveria nuk e autorizon më UNMIK-un si institucion që vepron në emër të saj dhe kjo pamundëson që Kosova ta shfrytëzojë mekanizmin e zgjidhjes së kontestit në kuadër të Sekretariatit që i është rekomanduar në vizitën e fundit që u bë në Bruksel. Masa e cila i mbetet Kosovës për të aplikuar si shtet sovran dhe i pavarur në kuadër të territorit me kufijtë e saj, në mbrojtje të ekonomisë është masa e reciprocitetit me Serbinë dhe me Bosnjë e Hercegovinën. Kjo do të nënkuptonte që pas një periudhe të caktuar Republika e Kosovës t'i aplikojë masat doganore për produktet e importuara nga Serbia, dhe jo bllokimin total atë që e aplikon Serbia.

Ekzistojnë tri mundësi të aplikimit të masës doganore me Serbinë: *e para* vlera e importit për vitin 2010 e produkteve nga Serbia ka arritur në 260 milionë euro, vlera e importit nga Bosnja dhe Hercegovina e ka arritur afërsisht gjysmën e kësaj shume, kurse totali është diku rreth 360 milionë euro. Sikur doganat e Kosovës të fillojnë me aplikimin e reciprocitetit për këto produkte, atëherë do të kemi një të hyrë shtesë prej afro 36 milionë eurosh vlerë doganore në buxhetin e Kosovës. Opsioni i dytë, vetëm 50% e importit t'i nënshtrohet taksës doganore, duke marrë parasysh që disa produkte strategjike, që janë më rëndësi për Kosovën, të mos doganohen. Kurse opsioni i tretë është opsioni radikal i bllokimit të tërësishëm të importit nga ana e Serbisë, si pasojë e së cilës do të jetë humbja e TVSH-së.

Gjatë takimit në Bruksel është kërkuar nga Komisioni Evropian zbatimi i Marrëveshjes së CEFTA-së nga ana e Serbisë dhe vulat doganore kanë hyrë edhe në dialogun ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Deri me tani nuk ka pasur asnjë rezultat konkret, prandaj Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë prezantimin e qëndrimeve të saj, sepse është e gatshme që të bisedojë. Po ashtu edhe në vizitën e presidentit të Komisionit Evropian, z. Barroso dhe komisionarit për Zgjerim, z. Fyle, është kërkuar të bisedohet për këtë çështje. Nga Kosova është kërkuar të presë tri apo katër javë, në mënyrë që Serbia ta shqyrtojë qëndrimin e saj dhe pas kësaj periudhe të fillojë një masë e reciprocitetit. Në Bruksel është diskutuar edhe për marrëveshjet preferenciale me vendet e BE-së, një masë tjetër tregtare, që e ka renduar ekonominë e Kosovës për vitin 2011, që ka filluar si problem politik dhe tani ka mbetur si problem procedural. Ajo çka ka ndodhur është se në dhjetor të 2010 Mbretëria e Bashkuar ka kërkuar të hiqet thirrja e Kosovës 1244 nga Marrëveshja për Tregti Preferencialë të BE-së, që i ka nxitur vendet që nuk e kanë njohur Kosovën të reagojnë dhe kësaj mase preferenciale i është ndërprerë funksionaliteti, kurse në janar arrihet një marrëveshje kompromisi me vendet anëtare, por tani çështja ka mbetur midis Këshillit dhe Parlamentit Evropian.

Pas vizitës së fundit dhe takimit me përfaqësuesit e Presidencës së BE-së, përkatësisht me drejtorin e Departamentit të Politikave Tregtare të Hungarisë është thënë se me 22 dhe 23 qershor në Parlamentin Evropian do të diskutohet Pakoja e Masave Tregtare të BE-së, që është një pako shumë e gjerë, në të cilën hyn edhe Marrëveshja Preferenciale me Kosovën. Nëse kjo kalon në Parlamentin Evropian mund të presim rifunksionalizimin e kësaj Marrëveshjeje deri në shtator të këtij viti. Në fund nga vetë komisionari Fyle është diskutuar dhe është iniciuar kjo, andaj kërkojmë nga Komisioni që kjo çështje të jetë në agjendën e bisedimeve me parlamentarët evropianë për fillimin e negociimit të Marrëveshjes Preferenciale Tregtare ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Kjo është një çështje për të cilën duhet një periudhë e gjatë negociimi, por është një proces i domosdoshëm, sidomos për procesin e aderimit. Afro 80% të politikave të BE-së në kuadër të Ministrisë për Integrim Evropian këtë vit dhe vitin e ardhshëm

kanë të bëjnë me politikat tregtare dhe bujqësore, prandaj shpresojmë në një bashkëpunim të mirë me këtë Komision Parlamentar.

Kryetari – Pyeti nëse ka pasur efekt dialogu teknik në kuadër të CEFTA-s në rolin dhe në kompetencat tuaj si ministre e Tregtisë dhe e Industrisë nga ana e zv.kryeministres Tahiri? Sa janë të përfshirë në këto bisedime ekspertët e kësaj Ministrie, këshilltarët dhe sa janë të besueshëm ata?

Alma Lama - Fillimisht pati një vërejtje për ministren dhe kërkoi që herën tjetër ta dorëzojë raportin me shkrim tri ditë para mbajtjes së takimit me Komisionin Parlamentar, në mënyrë që anëtarët e Komisionit të përkatiten dhe takimi të jetë më profesional dhe të mos vijnë informacione *ad hoc*. Ajo pyeti Ministren çka kupton me reciprocitet në lidhje me çështjen e CEFTA-s dhe për futjen e kësaj çështjeje në dialog me Serbinë, që nuk do të duhej të futej, sepse CEFTA është marrëveshje bilaterale ndërmjet shteteve të rajonit dhe jo çështje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Po ashtu u ngrit çështja se a po bëhet dialog paralel për çështje të CEFTA-s nga Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë dhe nga zv.kryeministria Edita Tahiri. U tha se kur mendohet për masat që do t'i ndërmarrë Kosova ndaj Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës, Kosova nuk do të jetë humbëse, sepse eksporti i Kosovës është minimal, kurse Serbia do të humbë diku rreth 230 milionë euro. Marrja e këtyre masave do t'i orientojë tregtarët në rrugë të tjera dhe sipas ekspertëve do të ketë rritje të çmimeve, por do të forcohet pozita politike e Kosovës dhe nuk do të lejohej më përfaqësimi i saj nga ana e UNMIK-ut. Kosova në CEFTA vetëm sa ka humbur për shkak se nuk arrin ta mbrojë tregun dhe bizneset e saj. Ndoshta është më mirë që Kosova të tërhiqet krejtësisht nga CEFTA, sepse nuk është në interes të qytetarëve të saj.

Mimoza Kusari – Lila – Pohoj se CEFTA është një marrëveshje multilaterale, mirëpo problemi ka zbritur në nivelin bilateral ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Si zv.kryeministre për ekonomi jemi të njoftuar nga zv.kryeministria për dialog dhe vazhdimisht jemi në kontakt. Sa i përket çështjes së kompetencave nuk është për t'u shqetësuar. Propozimi i Serbisë që ka dalë nga raundi i parë i bisedimeve, për ne është tërësisht i papranueshëm, sepse kërkohet të ndërrohet formati i vulës doganore, me qëllim që këtë problem ta shndërrojë nga niveli bilateral në nivel multilateral. Si pasojë e kësaj për të pastaj do të duhej të bisedohej me të gjitha shtetet. Qëndrimi ynë ka qenë i qartë se vula e doganës duhet të pranohen në formatin që janë dhe të respektohet Marrëveshja. Kosova si shtet nuk mund të presë pafundësisht. Për këtë do të ndërmarrim masa, sepse vlera e importit nga Serbia është afro 300 milionë euro, kurse vlera e eksportit nga Kosova nuk është as 20 milionë euro.

Çështjet e dialogut janë çështje teknike kurse Kosova në CEFTA nuk ka dashur të përfaqësohet nga UNMIK-u. Në vitin 2006 UNMIK është ai i cili e ka bërë nënshkrimin e Marrëveshjes për Tregti të Lirë, dhe po të bëhej një amendamentim i kësaj Marrëveshjeje do të nënkuptonte negocimin me të gjitha vendet anëtare të CEFTA-s, ku tri vende të saj dhe pesë vende të BE-së nuk e kanë njohur ende Kosovën si shtet të pavarur. Sa i përket faktit të reciprocitetit duhet të jemi të vetëdijshëm për kapacitetin e prodhuesve vendorë dhe për situatën në tregun e Kosovës. Nga lista e produkteve, që importohen nga Serbia, 7% të kësaj vlere kanë të bëjnë me grurë dhe me drithëra që janë të domosdoshme për Kosovën. Bllokimi i tërësishëm i këtij malli në kufijtë e Kosovës do të ndikojë edhe në aspektin psikologjik të ngritjes së çmimit të bukës. Kosova është e vetëdijshme për pasojat që mund t'i kenë qytetarët nga vënia e masës së reciprocitetit, por duhet t'i tregohet edhe Serbisë që në kuadër të kësaj Marrëveshjeje mund të ndërmerren masat të reciprocitetit. Në kuadër të Marrëveshjes së CEFTA-s dihet se nuk aplikohen masat doganore, mirëpo është një masë doganore që është aplikuar nga shtetet anëtare gjatë kontesteve të tyre (si rasti ndërmjet Kroacisë dhe Maqedonisë). Kosova është në një situatë jo të lakmueshme. Ajo merr pjesë në CEFTA në nivel të ministrave në Bruksel, ku UNMIK është nënshkrues i Marrëveshjes. Po ashtu Kosova e paguan taksën vjetore për anëtarësim. Kosova në CEFTA ka përfitime nga shtetet e tjera anëtare, që e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur. Megjithatë do të kërkohet një zgjidhje më pak e dëmshme për qytetarët e Kosovës. Kjo është arsye e bërjes publike të masave të reciprocitetit te Sekretariati në CEFTA dhe te Komisioni Evropian. Nëse Kosova ka rrezik të dënohet për marrjen e këtyre masave, atëherë mund të thuhet se në kuadër të kësaj Marrëveshjeje Kosovën do të përfaqësojë UNMIK-u.

Sa i përket paralelizmit në dialog, ky është një proces i cili është suplementar dhe tërësisht komplementar në koordinim ndërmjet ministres së Tregtisë dhe të Industrisë dhe zv.kryeministres Tahiri, për t'i përfaqësuar qëndrimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Humbjet e Kosovës në raport me Marrëveshjen e CEFTA-s janë kryesisht me shtetet si Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina. Po të dalë Kosova nga CEFTA, do të ishte një veprim jo i mirë, sepse do të ktheheshim mbrapa për të negociuar për aplikimin e masave doganore me të gjitha shtetet anëtare të CEFTA-s, sepse e dimë se i gjithë rajoni është në proces të integritimit evropian dhe të zbatimit e kushteve për aderim në BE. Vetëm një ditë më parë Shqipëria dhe Serbia i kanë hequr të gjitha barrierat doganore dhe Marrëveshja ka arritur funksionalizimin e plotë. Edhe pse Shqipëria ka qenë përkrahëse e vazhdueshme e Kosovës, për interesa të saj ekonomike e ka zbatuar këtë Marrëveshje. Vitin e kaluar Kosova ka pasur pengesa në eksportim të produkteve të saj edhe në tregun e Shqipërisë. Kurse me aplikimin e masës së reciprocitetit ndaj shteteve që e aplikojnë masën doganore do të bëhet e njëjta gjë edhe nga ana e Kosovës. Ne kemi qenë shumë të zëshëm për Marrëveshjen e CEFTA-s. Përsëri synojmë të mbajmë qëndrim që ta bëjmë atë më të aplikueshme në një afat të caktuar për një masë

doganore të reciprocitetit. Siç dihet produktet e Serbisë në Kosovë shiten kryesisht nga tregtarët kosovarë dhe nëse aplikohen masa doganore këta tregtarë do të gjejnë rrugë të tjera dhe si pasojë do ta bëjnë edhe rritjen e çmimeve.

Alma Lama – Tha se ju treguat raportet me Shqipërinë që aplikon masat doganore, duke thënë se CEFTA ka dështuar në tërësi dhe Kosova nuk arrin të aplikojë masa të reciprocitetit. Dalja nga CEFTA, u cilësua vendim radikal, por më radikal është fakti që ekonomia e Kosovës po humb në mënyrë të vazhdueshme si pasojë e këtyre masave doganore që po i aplikojnë Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Kjo është retorika pro integriteteve, por dihet se Kosova është shumë larg proceseve të integriteteve dhe në këtë rast më të rëndësishme janë interesat e prodhuesve dhe të buxhetit të saj. Pyetja konkrete ishte kryesisht në lidhje me rastin e Shqipërisë. Po ashtu është dëgjuar se në nivel të administratës së zyrtarëve qeveritarë ka kontakte dhe takime me zyrtarët serbë nëpër lokale të ndryshme që po diskutohet për vulat doganore.

Albert Kinolli – E pyeti ministren për dy çështje: *E para*, që ka të bëjë me raportimin e donatorëve gjatë vizitës suaj në Bruksel, a ka pasur rekomandime të qarta për ato çështje dhe *e dyta* rreth bisedimeve me Serbinë, nëse ka pasur qëndrime të përbashkëta ndërmjet jush dhe zv.kryeministres Tahiri, sa kanë arrit të harmonizohen ato sa u përket çështjeve të CEFTA-s?

Mimoza Kusari – Lila - U shpreh se ajo që ka ndodhur me Shqipërinë është një shkelje e Marrëveshjes për Tregti të Lirë, ku kjo e fundit në Kabinetin e Ministrave e aplikon një listë të produkteve që importohen dhe Qeveria e përcakton çmimin e këtyre produkteve. Është një ndërhyrje e drejtpërdrejtë në tregun, që i ka dëmtuar produktet e fermerëve kosovarë, sepse çmimi ka qenë i ndryshëm nga ai i fermerëve dhe i tregut. Po shikohet mundësia që edhe Kosova të aplikojë masën e njëjtë që Shqipëria e aplikon për produktet tona. Në kuadër të politikave të Qeverisë ndaj këtyre vendeve Kosova është cilësuar shumë konstruktive, kurse faturën e këtij veprim konstruktiv e ka paguar ekonomia, ndërsa, në agjendën zhvillimore të Qeverisë së re të Kosovës hyjnë edhe problemet që ekzistojnë por që duhet të zgjidhen. Në raport me Shqipërinë në ditët dhe në muajt e fundit nuk është ndërmarrë diçka për këtë çështje, ndërsa po afrohet sezoni ku do të kemi prodhime në mënyrë aktive nga prodhuesit kosovarë dhe në të njëjtën kohë dhe kërkesa nga ana e Shqipërisë për këto produkte.

Nga aplikimi i masës së reciprocitetit është e ditur që një numër prodhuesish kosovarë do të preken drejtpërdrejt, edhe pse ka mirëkuptim edhe nga ana e tyre. Ne duhet të kthehemi në një gjendje proaktive dhe të krijojmë lehtësime për kapërcimin e barrierave për të bërë biznes në Republikën e Kosovës. Sa i përket raportimit të donatorëve është përfshirë pjesa e raportimit të

të gjithë donatorëve për Kosovën në kuadër të Komisionit Evropian dhe të CEFTA-s. Kjo më tepër ka të bëjë me çështje teknike administrative të funksionimit të Sekretariatit të CEFTA-s dhe jo me çështje politike. Nga buxheti i Kosovës për këtë vit paguhen 16 mijë euro. Sa i përket qëndrimeve ato janë plotësisht të harmonizuara. Siç dihet, agjenda e këtyre bisedimeve është caktuar nga kryeministri i Kosovës me përfaqësuesit e BE-së. Çështja e vulave doganore dhe CEFTA janë përfshirë si tema për të cilat do të diskutohet në këtë dialog. Në këtë dialog, si përfaqësues i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ka marrë pjesë drejtori i Departamentit për Tregti.

Ministrja po ashtu foli për përfshirjen në dialog të ekspertëve në nivel të shërbyesve civilë dhe jo të këshilltarëve politikë, siç ka qenë rasti i drejtorit të Departamentit të Tregtisë në kuadër të CEFTA-s, kurse sa i përket vulave doganore ka marrë pjesë drejtori i Doganave të Kosovës, Naim Huruglica dhe përfaqësuesit e BE-së dhe të ShBA-ve. Ne kemi qenë në linjë të diskutimit dhe të përfaqësimit të nivelit më të lartë në nivel të shërbimit civil për çështjen e CEFTA-s dhe të vulave doganore. Kurse sa u përket takimeve të fshehta tha se nuk ka informacione për takime të tilla. Takime po mbahen në Bruksel dhe ato pa praninë e simboleve dhe të flamujve. Takimet, agjenda, pjesëmarrësit dhe çështjet që do të diskutohen janë bërë të gjitha publike. Në fund tha se muajin qershor Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë do ta mbajë një takim me CEFTA-n dhe juve si Komision do t'ju dërgohet ftesa për të marrë pjesë.

Kryetari – Falënderoi ministren, duke pohuar se në pjesën e tretë të këtij viti, në bazë të Planit të Veprimit të Kuvendit, përsëri do t'i bëhet ftesë të raportojë, kurse në të ardhmen presim një bashkëpunim dhe koordinim shumë më të mirë.

4. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 04. 05. 2011 dhe të 11. 05. 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet të mbledhjeve të 04. 05. 2011 dhe të 11.05.2011 pa vërejtje.

5. Të ndryshme

Kryetari - Theksoi se përgjegjësia për organizimin e mbledhjeve të Komisionit bie mbi administratën, kurse takimet e Komisionit do të mbahen kryesisht të martave rreth orës 11:00.

Albert Kinolli - Propozoj që në takimet e Komisionit me ministra të vendosen emrat përpara anëtarëve të Komisionit.

Alma Lama - Tha se ka disa çështje për t'i diskutuar, si: njoftimi i anëtarëve të Komisionit se kush nga ministrat do të ftohet për raportim, dhe dorëzimi i raporteve të bëhet me shkrim nga ministrat tri ditë para se ata të vijnë në raportim; në të gjitha takimet me ministra të ftohen mediat që të jenë të pranishme dhe Kuvendit nëpërmjet faqes zyrtare të internetit ta bëjë një informim të drejtë dhe të balancuar; sa i përket stafit të administratës duhet të dihet cilët janë personat e angazhuar në Komision dhe cilat janë detyrat e tyre; njoftimi për takimet me delegacionet e huaja; informim për organizatat që e mbështesin punën e Komisionit dhe shërbimet që i ofrojnë ata, si bëhet angazhimi i ekspertëve etj., si dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve dhe ndarja në grupe pune për Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lutfi Haziri